

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD, letër zyrtare Peleshit: Të ngrihet Komision Hetimor për zgjedhjet e 11 majit
ADRESA	https://www.cna.al/politike/pd-leter-zyrtare-peleshit-te-ngrihet-komision-hetimor-per-zgjedhjet-e-1-i475266
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:01:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 14:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6fac34e761bb911296f744efb50496cf91462ef15722f80820edfe65924b4fcc
TEKSTI	0fb0c332ec248efe58955aad97fc15c0a5fbd3206d5f6de98f4efa7b309c314e
PAMJA	6b75713394cfe0697c54f1b89e91559da601e9597d327e086e52c8fbccde5778

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	841086a522d35d2b071e53d706053feca60617433f061a99f89737ff8247f1c2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/841086a522d35d2b071e53d706053feca60617433f061a99f89737ff8247f1c2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

16:51 Kronika

Një autobus ka marrë flakë në hyrje të tunelit të Elbasani...

PD, letër zyrtare Peleshit: Të ngrihet Komision Hetimor për zgjedhjet e 11 majit



26 Shtator 2026, 16:48, Politikë CNA



Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i është drejtuar me një letër zyrtare kryetarit të Kuvendit, Niko Peleshi, duke kërkuar zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ngritjen e një Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit.

Bëhet fjalë për një kërkesë lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore dhe krimin e organizuar.

Sipas PD-së, vendimi, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, më 22 korrik 2026, ka hyrë në fuqi po atë ditë. Grupi Parlamentar i PD-së argumenton se, në zbatim të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, çështja duhej të shqyrtohej brenda 30 ditëve nga Këshilli i Legjislationit.

"Prej më shumë se dy muajsh, ju, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për nisjen e procedurës parlamentare për zbatimin e këtij vendimi detyrues të Gjykatës Kushtetuese, jeni duke shkelur nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë", thuhet në letërën e Grupit Parlamentar të PD-së.

Refuzimi apo vonesa në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është e papranueshme për opozitën”, thuhet më tej në letër.

PD kërkon marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në shkresën e grupit parlamentar të PD nr. 3452 Prot., datë 27.07.2026”, -thuhet ndër të tjera në letër./CNA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3452/1 Prot.

Tiranë, më 25/09 /2026

Lënda:

Ripërsëritje e kërkesës për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 62/2026.

Drejtuar:

Z. Niko PELESHI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Në vijim të shkresës sonë nr. 3452 Prot., datë 27.07.2026, me anë të së cilës kemi kërkuar ndjekjen e procedurave parlamentare për zbatimin e vendimit nr. 62/2026 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Jemi të detyruar t'ju rikërkojmë përsëri që ju të përmbushni detyrimet tuaja kushtetuese. Prej më shumë se 2 muajsh, ju në cilësinë e autoritetit përgjegjës për nisjen e procedurës parlamentare për zbatimin e këtij vendimi detyruar të Gjykatës Kushtetuese, jeni duke shkelur nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.


Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë **22.07.2026** dhe ka hyrë në fuqi atë ditë. Për këtë arsye, duhet të ishte marrë në shqyrtim sipas nenit 87 të Rregullores së Kuvendit brenda 30 ditëve nga Këshilli i Legjislacionit, që mbledhet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit. Mosveprimi juaj antikushtetues po cenon rëndë të drejtat e pakicës parlamentare dhe shtetin e së drejtës. Refuzimi apo vonesa në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është e papranueshme për opozitën dhe provon degradimin institucional të Kuvendit të Shqipërisë.

Përsa më lart, kërkojmë të merrni masa menjëherë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të përmbushni detyrimet tuaja sic ju është bërë me dije në shkresën nr. 3452 Prot, datë 27.07.2026 të Grupit Parlamentar të PD.

Gazment BARDHI

KRYETARI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE



Të sugjeruara

Takimi në Presidencë/ Zbardhen diskutimet e ambasadorit të ri të SHBA-së me Begajn

3 shqiptarë humbën jetën nga tragjedia në Athinë/ Deputeti: Ministria dhe Ambasada, asnjë reagim

Ministri Demo viziton Kombinatin: Nis rindërtimi për banesat e reja, pasojë nga tërmeti i 2019-ës

Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Salla bosh, bojkot Padrinos

"Ripërtëritja e PD-së, jetike për vendin"/ Berisha: Situata aktuale kërkon ndërhyrje të menjëhershme

"Transparencë, jo ngadalësim"/ Rama në OKB: Duhet marrëveshje ndërkombëtare për një IA sovrane

"Revolucioni i Flamingove"/ Rama: U fabrikua narrativa e pushtimit të bregdetit nga izraelitët

Rama në OKB: Rreziku më i madh nga IA, t'i bindet njeriut të gabuar

"Thaçi u tradhtua nga Biden"/ Rama nga New York: Sistemi demokratik i Shqipërisë po ndërton imunitet

Protestat kundër tij/ Rama: Pulat hysterike i gënjen mendja se do më ndalin me llogjet për korrupsionin

"100 bashki dhe 12 qarqe"/ PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit

Skandali i SHISH-it/ Ja kur pritet të mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

Detajet/ Rama mban nesër fjalën e tij para OKB-së

Zbardhen diskutimet/ Ministri Hoxha takohet në New York me Kaja Kallas

Kuvendi miraton projektligjin për dërgimin e trupave në Gaza

Berisha: Vlora Hyseni u emërua jashtë kritereve, shërbëtore e Ramës dhe Vuçiç-it

"Jemi në dorë të krimit"/ Korreshi: Skandali i SHISH-it ka fikur radarët e shtetit, ia ka plasur Begajt

Pas shkarkimit të Vlora Hysenit/ Begaj mbledh në takim Demon, Hitën dhe drejtorin e komanduar të SHISH-it

Skandali i SHISH-it/ Këlliçi në Kuvend: Nuk është çështje partiake, të mos harrohet interesi kombëtar

"Do të zëvendësohesh, u solle si tuhaf"/ Replika Berisha-Pelesh: Më marrsh të keqen!


[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.